


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1155 Rep.

Nr. 576/2 Kol.



KONTRATE SHITJE

Ne Tirane, sot me date 05.07.2006(dymije e gjashte), perpara meje noteres Majlinda E. Demollari, anetare e dhomes se notereve Tirane, me seli ne Rr" Vaso Pasha" u parqiten personalisht :

SHITESI : Lyubomir Nedkov Kyuchukov, I datelindjes 1955, shtetas Bullgar, madhore me zotesi per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. 184361428 , i perfaqesuar me prokure date 16.01.2006 nr. 4 regj dhe nr. 3.00 kol nga Haneme Bakiaj, e datelindjes 1953, banuese ne Tirane madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, e njohur personalisht prej meje.

BLERES: Vladimir Agalliu, I biri I Aliut ,I datelindjes 1948, madhor me zotesi per te vepruar, banues ne Tirane , mbajtes I leternjoftimit me nr. UG 013915.

Z. Lyubomir Nedkov Kyuchukov me cilesine e shitesit dhe Z. Vladimir Agalliu me cilesine e Bleresit deklaruan se jane ortak te shoqerise " SELAS " shp.k e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 3149 date 29. 03.1994 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ku sejcili ortak gezon nga 50% te kapitalit.

Kapitali fillestar i shoqerise "SELAS" sh.p.k ka qene 200.000 leke (dyqind mije). Me vendim nr. 3149/2 date 15.02.2006 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte bere depozitimi I vendimit te Asamblese se ortakeve per rritjen e kapitalit te shoqerise ne vleren 7.400.000 leke(shtate milion e katerqind mije)

Shitesi Lyubomir Nedkov Kyuchukov deklaroi se me vullnet te lire e te plote se ia shet 50% te pjeses se kapitalit qe gezon te shoqerise "SELAS" ne vleren 3.700.000 (tre milion e shtateqind mije) Z. Vladimir Agalliu duke u zhveshur keshtu nga e drejta e pronesise mbi keto aksione.

Bleresi Vladimir Agalliu deklaroi se me vullnet te lire e te plote I blen shitesit Lyubomir Nedkov Kyuchukov pjesen e kapitalit prej 50 % te zoteruar prej tij dhe ortak i vetem i shoqerise "SELAS" eshte Z. Vladimir Agalliu me kapital 100% ne vleren 7.400.000 leke(shtate milion e katerqind mije)

Pas kesaj shitje shitesi zhvishet nga e drejta e pronesise mbi kapitalin e zoteruar prej tij dhe bleresi behet zoterues i 100 % te kapitalit te shoqerise duke marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne kete shoqeri.

Palet deklaruan se i kane bere likuidimet dhe nuk kane asnje detyrim ndaj njeri tjetrit.

Kontrata u hartua ne kater kopje me vlere te njejte, u lexua me ze, dhe meqenese shpreh vullnetin e lire e te plote te paleve, nenshkruset prej tyre rregullisht dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

SHITESI

Lyubomir Nedkov Kyuchukov
perfaqesuar me prokure nga
Haneme Bakiaj

Haneme Bakiaj
[Signature]

BLERESI

Vladimir Agalliu

Vladimir Agalliu
[Signature]

[Faint stamp]
[Signature]